



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 378/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Diarta Vishesella kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Shtime, paraqitur kudër Fidaim Shabani kryesues i vendvotimit 2206E/01R për shkak të gabimeve teknike gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL A.nr 378/2017 e datës 23.10.2017, e parashtruar nga Diarta Vishesella kandidate për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Shtime, paraqitur kudër Fidaim Shabani kryesues i vendvotimit 2206E/01R, për shkak të gabimeve teknike gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 23.10.2014, nga Diarta Vishesella nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Shtime në të cilën pretendon se në vendvotimin 2206E/01R i janë bërë gabime teknike gjatë numërimit të votave.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me gabimet gjatë numërimit të votave në vendvotimin 2206E/01R për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen

e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së ankueses Diarta Vishesella, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr. 378/2017 më datën 24.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.